



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORI I PËRGJITHSHËM

Nr. 864..... Prot.

Tiranë, më 19.01.2026

URDHËR

Nr. 7, Datë 19 / 01 / 2026

**PËR MIRATIMIN E FORMULARËVE A1/A1Z DHE UDHËZUESVE PÛRKATËS PËR
MATURËN SHTETËRORE DHE MATURËN SHTETËRORE PROFESIONALE 2026**

Në mbështetje të Ligjit nr. 69, datë 21.06.2012, "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 78, datë 08.02.2006, "Për krijimin e Maturës Shtetërore dhe pranimet në shkollat e larta", i ndryshuar, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 1013, datë 10.12.2010, "Për krijimin e Agjencisë Kombëtare të Provimeve", i ndryshuar, të Urdhrit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Sportit dhe Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr.661, datë 01.12.2023, "Për miratimin e Rregullores për zhvillimin e Maturës Shtetërore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe Udhëzimit të përbashkët të Ministrit të Arsimit dhe Ministrit të Ekonomisë dhe Inovacionit nr. 27, datë 30.12.2025, "Për organizimin dhe zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore dhe të Maturës Shtetërore Profesionale 2026",


URDHËROJ

1. Miratimin e formularëve A1/A1Z, të udhëzuesve përkatës dhe grafikun e aplikimeve për Maturën Shtetërore dhe Maturën Shtetërore Profesionale 2026, sipas dokumenteve bashkëlidhur, pjesë përbërëse të këtij urdhri.
2. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Qendra e Shërbimeve Arsimore, Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar, Drejtoritë Rajonale të Arsimit Parauniversitar, Zyrtat Vendore të Arsimit Parauniversitar dhe institucionet arsimore.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Aida Myrto





Qendra e Shërbimeve Arsimore

FORMULARI A1

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATURËN SHTETËRORE 2026

Plotësohet vetëm nga maturantët që përfundojnë shkollën e mesme në vitin 2026

I. Të dhëna personale.

Plotësohen nga maturanti.

1. Numri personal në letërnjoftimin ID _____
2. Emri: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____
3. Datëlindja: (dd/mm/vvvv) ____/____/____
4. Vendlindja e maturantit _____
5. Gjinia: ☐ Femër ☐ Mashkull
6. Adresa e e-mail-it _____ Telefoni i kontaktit maturantit/mbikëqyrësit:
06 _____
7. Do të aplikoni për studime jashtë vendit? Po ☐ Jo ☐

II. Të dhëna shkollore.

Plotësohen nga maturanti.

8. Emri i qytetit/fshatit: _____
9. Emri i shkollës ku studion: _____

Plotësohen nga mbikëqyrësi.

10. ZVAP _____
11. Indeksi i profilit: _____
12. Emërtimi i profilit _____
13. Klasa III / IV: Emërtimi i paralelit të klasës (A, B, C, D, E, F, G, H, I, J, K, L, M, N, O, P, Q, R, S, T)
14. Gjuha e huaj e detyruar që do të japë provim. D3

Plotësohen nga maturanti.

15. Lëndët me zgjedhje:

Lënda e zgjedhur Z

LISTA E LËNDËVE ME ZGJEDHJE PËR GJIMNAZET, SHKOLLAT E MESME ARTISTIKE DHE SHKOLLAT E MESME PROFESIONALE

Nr.	Lënda
I.	Për shkollat e mesme (Gjimnazet)
1	Kimi
2	Fizikë
3	Biologji
4	Histori
5	Gjeografi
6	Qytetari dhe Psikologji
7	Filozofi dhe Sociologji
8	Ekonomi
II.	Për shkollat e mesme Artistike
9	Histori muzike
10	Histori arti
11	Histori baleti

Teknologji dhe TIK - QBNND

Nr	Lënda
III.	Për shkollat e mesme Profesionale
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK
26	Zhvillim Website
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike softwaresh (Hermann Gmeiner)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanikë (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim nafte, gazi dhe uji
37	Shërbime, kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)
38	Shërbime të udhëtimit dhe turizmit
39	Riparime të pajisjeve elektronike
40	Telekomunikacion
41	Teknologji Bujqësore
42	Programim
43	Multimedia
44	Administrim Zyre
45	Shërbime mekatronike në automjete
46	Termohidraulikë
47	Guidë Turistike



Qendra e Shërbimeve arsimore

FORMULARI A1Z

PËR REGJISTRIMIN E KANDIDATËVE NË MATUREN SHTETËRORE 2026

Plotësohet vetëm nga kandidatët që kanë kryer shkollën e mesme para vitit 2026

I. Të dhëna personale

Plotësohen nga kandidati

1. Numri personal në letërnjoftimin ID _____
2. Emri: _____ Atësia: _____ Mbiemri: _____
3. Datëlindja: (dd/mm/yyyy) ____/____/____
4. Vendlindja e maturanit _____
5. Gjinia: ☐ Femër ☐ Mashkull
6. Adresa email-it _____ Telefoni i kontaktit maturanit/mbikëqyrësit:
06 _____
7. Do të aplikoni për studime jashtë vendit? Po ☐ Jo ☐

II. Të dhëna shkollore.

Plotësohen nga kandidati

8. Emri i qytetit/fshatit: _____
9. Emri i shkollës: _____

Plotësohen nga mbikëqyrësi

10. ZVAP: _____
11. Indeksi i profilit: _____
12. Emërtimi i profilit _____

III. Të dhëna lëndore.

Plotësohen nga kandidati

13. ID e kandidatit
14. Viti i përfundimit të shkollës së mesme _____
15. Ka marrë dëftesë pjekurie/diplomë Po ☐ Jo ☐
16. Lëndët e detyruara:
 - 16.1. Lëndët e detyruara që do mbarten:
Lënda D1 _____ Nota e shkallëzuar D1 _____
Lënda D2 _____ Nota e shkallëzuar D2 _____
Lënda D3 _____ Nota e shkallëzuar D3 _____
 - 16.2. Lëndët e detyruara që do të japësh provim:
Lënda D1 _____ Lënda D2 _____ Lënda D3 _____
17. Lëndët me zgjedhje:
 - 17.1. Lënda me zgjedhje që do të mbartet.
Lënda me zgjedhje Z _____ Nota e shkallëzuar Z _____, viti _____
 - 17.2. Zgjidh lëndën me zgjedhje që do të japësh provim:
Lënda me zgjedhje Z

**LISTA E LËNDËVE ME ZGJEDHJE PËR GJIMNAZET, SHKOLLAT E MESME ARTISTIKE DHE SHKOLLAT E MESME
PROFESIONALE**

Nr.	Lënda
I.	Për shkollat e mesme (Gjimnazet)
1	Kimi
2	Fizikë
3	Biologji
4	Histori
5	Gjeografi
6	Qytetari dhe Psikologji
7	Filozofi dhe Sociologji
8	Ekonomi
II.	Për shkollat e mesme Artistike
9	Histori muzike
10	Histori arti
11	Histori baleti

Nr	Lënda
III.	Për shkollat e mesme Profesionale
1	Hoteleri-turizëm
2	Shërbime mjetesesh transporti
3	Mekanikë
4	Elektroteknikë
5	Elektronikë
6	Përpunim druri
7	Ndërtim
8	Tekstil-konfeksione
9	Tekstil-konfeksione (NABER ADA)
10	Teknologji ushqimore
11	Bujqësi
12	Shërbime sociale dhe shëndetësore
13	Instalues i sistemeve termohidraulike
14	Teknologji kimike
15	Peshkim
16	Detari
17	Gjeologji-miniera
18	Llogari
19	Shërbime bankare
20	Sipërmarrje e agjencisë turistike
21	Sigurime
22	Tregti
23	Administrim biznesi
24	Rrjete të dhënash
25	Mbështetje e përdoruesve të TIK
26	Zhvillim Website
27	Rrjete të dhënash (pilot-GIZ)
28	Inxhinieri informatike softwaresh (Hermann Gmeiner)
29	Silvikulturë
30	Agrobiznes
31	Veterinari
32	Gjeodezi
33	Biznes (Harry Fultz)
34	Elektronikë (Harry Fultz)
35	Automekanikë (Harry Fultz)
36	Kërkim, shpim dhe shfrytëzim naftë, gazi dhe uji
37	Shërbime, kujdesi për të moshuar (pilot GIZ)
38	Shërbime të udhëtimit dhe turizmit
39	Riparime të pajisjeve elektronike
40	Telekomunikacion
41	Teknologji Bujqësore
42	Programim
43	Multimedia
44	Administrim Zyre
45	Shërbime mekatronike në automjete
46	Termohidraulikë
47	Guidë Turistike

Udhëzues për aplikimin në Maturë Shtetërore nga portali qeveritar

1. Krijimi i profilit në portalin qeveritar

Nëse ju nuk keni një profil në portalin qeveritar veproni si më poshtë:

- Hapni browser-in (Mozilla Firefox, Google Chrome, Internet Explorer) dhe klikoni:

www.e-albania.al

- Fillimisht bëjmë regjistrimin në portal. Për këtë ju duhet të klikoni tek **Regjistrohu**.

The screenshot shows the homepage of the e-Albania portal. At the top, there is a header with the logo on the left and navigation links: "KRYESÏRE", "E-SHËRBIME", "SHËRBIME INFORMATIVE", "NDIHMË DHE SUPORT", "Hyr | Regjistrohu", and "Register your business as a foreign citizen". Below the header is a search bar with the placeholder text "kërko shërbimin". The main content area is divided into several sections. The first section contains four boxes: "REGJISTRIME" (Registration), "INSTITUCIONE ARSIMORE DHE PROGRAME STUDIMORE" (Educational Institutions and Study Programs), "MATURA SHETËRORE" (Matura Shtetërore), and "NJËSIMI I DIPLOMAVE" (Diploma Unit). Each box has an icon and a link to "Shërbime për qytetarë". Below these is a box for "KURSE FORMIMI PROFESIONALE" (Professional Training Courses) with a link to "Shërbime për qytetarë". The bottom section is titled "Lista e shërbimeve" (List of services) and contains four boxes: "Aplikim për Fondin e Ekselencës" (Application for the Excellence Fund), "Aplikim për kopje të testit të maturës/iletëpërgjigjes së maturës" (Application for copies of the matura exam/answer sheet), "Aplikim për mbylljen e institucionit të arsimit parauniversitar privat, në të cilën zhvillohen edhe lëndë fetare apo ku mësimi zhvillohet edhe në gjuhë të huaj" (Application for the closure of private pre-university education institution, in which religious subjects are also taught or where teaching is also conducted in a foreign language), and "Aplikim për regjistrim për kurs formimi profesional" (Application for registration for professional training course). The page also features a footer with the address "Bulevardi Zhan D'Ark, Nr. 23, Tiranë" and the website "Web site: www.qsha.gov.al".

Më pas do plotësoni të dhënat siç ju kërkohen më poshtë:

Plotësoni të dhënat e përdoruesit



Kodi i përdoruesit (NID: Numri personal i identifikimit)*:

J01234567U

Vendosni numrin tuaj personal

Fjalëkalimi*:

Plotësoni fjalëkalimin

Vendosni Fjalëkalimin tuaj

Fjalëkalimi përsëri*:

Riplotësoni fjalëkalimin

Vendosni Fjalëkalimin përsëri

E-mail*:

example@domain.com

Vendosni një adresë të saktë e-maili

Numri i celularit*:

06xxxxxxx

Vendosni numrin tuaj të telefonit

Pyetja e sigurisë*:

Vendlindja e nënës

Përgjigjja e pyetjes së sigurisë*:

Mos harroni të plotësoni pyetjen tuaj të sigurisë dhe përgjigjen tuaj e cila do t'ju shërbeje në rast harrimi të fjalëkalimit.

Emri*:

Emri si në dokumentin tuaj të identitetit

Atësia*:

Plotësoni atësinë tuaj

Mbiemri*:

Mbiemri si në dokumentin tuaj të identitetit

Datëlindja*:

dd.mm.vvvv

Plotësoni datëlindjen tuaj



Unë miratoj përdorimin e të dhënave të mia personale

<--- Klikoni miratimin e të dhënave personale

Lexo të plotë

Lutemi kontaktoni asistencën ndaj qytetarit duke klikuar këtë mesazh ose tek login@e-albania.al

Regjistrohu

<--Klikoni Regjistrohu

Fushat që do të plotësoni janë:

- Kodi i përdoruesit (është numri personal që gjendet në kartën tuaj të identitetit, pasaportë apo certifikatë, siç tregohet në figurën më sipër).
- Fjalëkalimi: (vendosni një fjalëkalim tuajin).
- Fjalëkalimi përsëri: (ripërsëritni fjalëkalimin e vendosur më sipër).
- E-mail (**KUJDES!!** Vendosni një e-mail të vlefshëm dhe të saktë pasi do ju duhet në procedurat e mëvonshme).
- Nr. Celular (vendosni një numër të saktë pasi për t'u bërë i vlefshëm regjistrimi do merrni një kod që duhet ta përdorni brenda 120 sekondave).
- Pyetja e sigurisë dhe Përgjigja (Plotësojini këto dy fusha në rast se harroni fjalëkalimin tuaj).

Më pas vazhdoni me plotësimin e pjesës së dytë:

KUJDES!! Të dhënat duhet të jenë të sakta siç janë në dokumentet tuaj të identitetit. Këto të dhëna janë:

- Emri
- Atësia
- Mbiemri
- Datëlindja
- Nr. i letërnjoftimit (është numri që ka dokumenti juaj i identitetit – ai fillon me një shkronjë dhe përfundon me një shkronjë, në figurë është i rrethuar me vijë të kuqe).



Unë miratoj përdorimin e të dhënave të mia personale

Klikoni mbi katrorin si në figurë

dhe më pas shtypni butonin **Regjistrohu**.

Një kod do t'iu vijë në numrin tuaj të celularit që duhet ta përdorni brenda 120 sekondave.


Ju lutem vendosni kodin e regjistrimit qe ju ka ardhur ne SMS :

Klikoni **Vazhdo**. Në këtë moment profili juaj është krijuar.

Në adresën tuaj të email-it do t'ju vijë konfirmimi.


2. Logimi në portalin qeveritar

(Kjo vlen për përdoruesit e rinj që sapo krijuan profilin dhe ata ekzistues që e kanë tashmë një profil) .



Klikoni te : **Hyr**

Klikoni te : **Identifikimi i qytetarëve/bizneseve me fjalëkalim.**



Vendosni kredencialet tuaja (numrin personal dhe fjalëkalimin tuaj) dhe më pas **HYR**.



e mërkurë, 30 shtator 2020

Identifikimi

 J558260085V



[Keni harruar fjalëkalimin tuaj?](#)

 Hyr

Do t'ju shfaqet një pamje si në figurën më poshtë. Te fusha e kërkimit kërkoni me **Matura Shtetërore**, ose nëse zgjeroni kategorinë **Arsimi**, ju del shërbimi i Maturës Shtetërore.



KRYESORE | E-SHËRBIME | SHËRBIME INFORMATIVE | NDIHMË DHE SUPORT

ENJAL

 Dil


[Regjistroni një biznes](#)

[Kërko shërbimin](#) 

DOKUMENTE ME VULË ELEKTRONIKE		PAGESA ELEKTRONIKE	
 FAMILJA > Leje për dalje > Certifikatë personale > Certifikatë familjare Të tjera...	 ARSIMI > Matura Shtetërore > Kërkesë për kopje të testit... > Njësime të diplomave Të tjera...	 PUNA > Leje Punë > Verifikim të punësorëve > Aplikim për regjistrim në p... Të tjera...	 SHËNDETËSIA DHE MBROJTJA SOCIALE > Kartë e Shëndetit > Kontrolli mjekësor bazë > Ndihma ekonomike Të tjera...
 KONTRIBUTET DHE PENSIONI > Aplikim për pension pleqërie > Verifikim për pagesën e kont... > Kërkesë për shpërbim lindj... Të tjera...	 GJENDJA GJYQESORE > Formulim deklarativizimit > Dëshmimi e Penalitetit > Verifikim i parashitës Të tjera...	 BIZNESI IM > Aplikim për regjistrimin e > Verifikim për aktivitet ekon... > Aplikim për ushtrimin e ve... Të tjera...	 LEJE DHE LICENCA > Leje Ndërtimi > Licencë industriale > Lëshimi i titullit të licenc... Të tjera...

Pasi të jeni futur te Matura Shtetërore kliko **Përdor**.

Tashmë e keni mundësinë që të nisni aplikimin me formularët A1 apo A1Z duke klikuar **Apliko** figura më poshtë:



3. Formularët A1 / A1Z

Klikojmë tek **Apliko** duke zgjedhur formularin **A1** ose **A1Z**.
(përzgjedhja në përputhje me udhëzimet e Ministrisë përgjegjëse për arsimin).

3.1 Formulari A1

Do të ngarkohen automatikisht të dhënat tuaja personale (Pikat nga 1-6)

Matura Shtetërore AI

Matura Shtetërore A1

Formula A1

Plotësohet vetëm nga maturantët që përfundojnë shkollën e mesme

Plotësohet nga maturantët

2. **U.S. & Canada, 1998**

100

Atēsia:

100-443886-100

.....

† Mashkull ‡ Ferner

bioRxiv preprint doi: <https://doi.org/10.1101/181181>; this version posted February 1, 2018. The copyright holder for this preprint (which was not certified by peer review) is the author/funder, who has granted bioRxiv a license to display the preprint in perpetuity. It is made available under aCC-BY-NC-ND 4.0 International license.

II. Të dhëna shkollëre.
Picësohet nga maturanti

[illegible]

TEST - O - BERAT

SECRET

$$f_1(x) = \frac{1}{2} \left(\frac{1}{2} + \frac{1}{2} \right) = \frac{1}{2} \quad \text{for } x = \frac{1}{2} \quad \text{and} \quad f_1(x) = \frac{1}{2} \left(\frac{1}{2} + \frac{1}{2} \right) = \frac{1}{2} \quad \text{for } x = \frac{1}{2}$$
$$\frac{d}{dt} \left(\frac{1}{2} m v^2 + U \right) = -\nabla \cdot (\mathbf{v} p) + \rho \mathbf{v} \cdot \mathbf{g}$$

(A, B, C, D, E, F, G, H, I, J, K, L, M, N, O, P, Q, R, S, T)

Vũ
• HUY

Zoulin
 August 03
 Freight 03
 General 03
 Debt 03

III. Tē dženā lēndare.

- Zgjidhni DRAP dhe ZVAP në të cilën përfshihet shkolla ku po bëni aplikimin,
- Zgjidhni shkollën tuaj “Emri i shkollës ku studion” dhe automatikisht do të plotësohet Pika 8 (Qyteti/Fshati),
- Zgjidhni Vitin (III,IV,V) dhe Klasën (A,B,C,...),
- Te Pika 14 zgjidhni nga lista gjuhën e detyruar që do të jepni provim,
- Te pika 15 do zgjidhet lënda me zgjedhje që do të jepet provim.

Të gjitha të dhënat e tjera për fushat që janë në ngjyrë gri (të paeditueshme), do t'i plotësoni në shkollë, ditën e përcaktuar për këtë qëllim, bazuar në kalendarin e aplikimit të publikuar nga QSHA.

III. Të dhëna lëndore.

15. Lënda me zgjedhje:

Zgjidh
ADMINISTRIM BUDJET
ADMINISTRIM
ANGLISHT
AUTOMATIKIM (MATEMATIKË)
BIOLOGJI
BIOLOGJI BËRTANOR
BIOLOGJI E TRILLIMAT
BIOLOGJI (MATEMATIKË)
BURQESI
DETARE
EDUKIM
EDUKIM BËRTANOR

KUJDES!!

Plotësimi të bëhet në përputhje me udhëzimin për plotësimin e formularit A1, MSH 2026.

Pasi të jeni siguruar për të dhënat që plotësuar, klikoni butonin **Dërgo**.

Do merrni njoftimin: **Paraqituni në shkollë të përfundoni aplikimin!**

I njëjti mesazh do t'ju vijë dhe në celularin dhe adresën tuaj të e-mail.

Klikoni **Dil** për të dalë nga portali qeveritar.

Matura Shteterore



FORMULARI A1



Paraqituni ne shkolle te perfundoni aplikimin!



Aplikimin do ta vazhdoni në shkollën tuaj, në ditën e përcaktuar për këtë qëllim, sipas kalendarit të publikuar nga QSHA. Vetëm në momentin kur formulari printohet nga sistemi e-matura, aplikimi konsiderohet i përfunduar dhe i konfirmuar.

Çdo maturant/kandidat do të plotësojë/firmosë në KSHMSH formularin A1/A1Z për saktësinë e të dhënave të tij në sistemin e-matura dhe ky formular ruhet nga KSHMSH-ja deri në përfundim të vitit shkollor përkatës.

3.2 Formulari A1Z

Do të ngarkohen automatikisht nga portali, të dhënat tuaja personale (Pika 1-6)

PËR REGJISTRIMIN E MATURANTËVE NË MATUREN SHTETËRORE
Plotësohet vetëm nga ata që kanë kryer shkollën e mesme para vitit korrent.

1. Të dhëna personale.

Plotësohen nga kandidati

1. Nr Personal në letërnjoftimin ID

2. Emri:

Atësia:

Mbiemri:

3. Datëlindja (dd/mm/yy):

4. Vendlindja e maturantit:

5. Gjinia:

☐ Mashkull

☐ Femër

Do të filloni me plotësimin e pjesës së dytë: **Të dhëna shkollore.**

- Zgjidhni DRAP dhe ZVAP në të cilën përfshihet shkolla ku po bëni aplikimin,
- Zgjidhni shkollën ku po bëni aplikimin (shkolla që ju është caktuar), automatikisht do të plotësohet Qyteti/Fshati.


Pjesa e tretë **Të dhëna lëndore** do të plotësohen në shkollë në prani të mbikëqyrësit në shkollën ku ju jeni përcaktuar për të aplikuar në përputhje me udhëzimet e miratuara.

Të gjitha të dhënat e tjera për fushat që janë në ngjyrë gri (të paeditueshme), do t'i plotësoni në shkollë, ditën e përcaktuar për këtë qëllim, bazuar në kalendarin e aplikimit me A1Z të publikuar nga QSHA.

KUJDES!! Plotësimi të bëhet në përputhje me udhëzimin për plotësimin e formularit A1Z, MSH 2026, të miratuar.

Pasi të jeni siguruar për të dhënat që plotësuat, klikoni butonin **Dërgo**.

Do te merrni njoftimin : Paraqituni në shkollë të përfundoni aplikimin!



I njëjti mesazh do t'iu vijë dhe në celularin dhe adresën tuaj të e-mail.

Klikoni **Dil** për të dalë nga portali qeveritar.

Aplikimin do ta vazhdoni në shkollën tuaj, në ditën e përcaktuar për këtë qëllim, sipas kalendarit të publikuar nga QSHA. Vetëm në momentin kur formulari printohet nga portali i maturës, aplikimi konsiderohet i përfunduar dhe i konfirmuar.

Çdo maturant/kandidat do të plotësojë/firmosë në KSHMSH formularin A1/A1Z për saktësinë e të dhënave të tij në sistemin e-matura dhe ky formular ruhet nga KSHMSH-ja deri në përfundim të vitit shkollor përkatës.

4. Harruat fjalëkalimin tuaj?

Në qoftë se maturanti e ka krijuar më herët profilin, por nuk mban mend fjalëkalimin mund të veprojë si më poshtë:

Vendos kredencialet e tij → Numër Personal → Një fjalëkalim çfarëdo → Kliko **IDENTIFIKOHU**

Do të shfaqen mesazhet:

Identifikimi dështoi



Konfirmoni identitetin tuaj për të ndryshuar fjalëkalimin

Kodi i përdoruesit (NIC/NUMS): *

1004221071

Vazhdo

Vendosni kodin e përdoruesit (NIC/NUMS), jepni përgjigjen e pyetjes së sigurisë dhe fjalëkalimi do të gjenerohet dhe do ju dërgohet me email.

Miksa më e mirë e fjalëve (fjalë)

Ndrysho fjalëkalimin

1. Më tej kërkohet të konfirmoni identitetin tuaj për të ndryshuar fjalëkalimin
2. Në dritaren që do të shfaqet plotësoni dhe një herë Kodin e përdoruesit (Numrin tuaj Personal)
3. Klikoni butonin **Vazhdoni**.
4. Përgjigjuni pyetjes së sigurisë që keni plotësuar kur keni bërë regjistrimin tuaj.
5. Klikoni butonin **Ndrysho fjalëkalimin**.
6. Në këtë moment do të njoftoheni me anë të një mesazhi: **Gjenerimi i fjalëkalimit të ri u krye me sukses. Fjalëkalimi i ri u dërgua në email-in tuaj.**
7. Pasi të hapni email-in tuaj merrni fjalëkalimin. *Kujdes!! Email mund të vijë dhe si Spam*
8. Logohuni me kredencialet e reja.



Konfirmoni identitetin tuaj për të ndryshuar fjalëkalimin

Kodi i përdoruesit (NIC/NUMS): *

1004221071

Vazhdo

Vendosni kodin e përdoruesit (NIC/NUMS), jepni përgjigjen e pyetjes së sigurisë dhe fjalëkalimi do të gjenerohet dhe do ju dërgohet me email.

Miksa më e mirë e fjalëve (fjalë)

Ndrysho fjalëkalimin

Nëse nuk mbani mend përgjigjen e duhur për pyetjen e sigurisë që keni vendosur kur jeni regjistruar dhe si pasojë tashmë nuk mund të gjeneroni një fjalëkalim të ri, atëherë mund t'i shkruani një email, suportit të portalit në adresën suportmatura@e-albania.al dhe shumë shpejt do të merrni një fjalëkalim të ri. Në këto raste është mirë që aplikimin ta bëni ditën e nesërme pasi të keni rihapur llogarinë tuaj në e-albania.

APLIKIMI ME FORMULARIN A1 NGA PROFILI I MBIKQYRËSIT NË PORTALIN E MATURËS SHTETËRORE


Hapi i parë - Mbikëqyrësi hap një nga browser-at: **Internet Explorer/Firefox/Chrome** etj.

Tek fusha e adresës web plotësohet <http://ematura.qsha.gov.al> dhe shtypet ENTER.

Do të hapet faqja kryesore e Portalit të Maturës Shtetërore.

Hapi i dytë - Aksesimi në sistem do të bëhet me kredencialet e e-Albania. Mbikëqyrësit duhet të kenë të konfiguruar te përdoruesi i tyre në sistem NID-in/numrin personal. Për arsye të veçanta kur këta përdorues do të duan të aksesojnë sistemin e-matura me përdorues dhe fjalëkalim (pra jo nga e-Albania) duhet të bëjnë një kërkesë tek QSHA dhe aty do t'u autorizohet identifikimi përmes përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës për të aksesuar sistemin. Pasi vendosim kredencialet e sakta klikojmë mbi butonin

 siç tregohet në figurën më poshtë:



Hapi i tretë - Pasi mbikëqyrësi klikon mbi butonin , hapet faqja web me ambientin e punës së mbikëqyrësit.

Në të majtë gjenden menutë kryesore të punës dhe po në të majtë në fund tregohet roli i përdoruesit, në këtë rast është mbikëqyrës formularësh.

duke klikuar mbi butonin **Apërko**, dhe duke e verifikuar maturantin nga lista e maturantëve, siç tregohet në figurën më poshtë:

Maturantë

ID	Emri	Data e lindjes	Sexi	Adresa	Shkollja	Profili	Adresa e kontaktit	Adresa e kontaktit	Adresa e kontaktit
1340220077	RIKETA JAKOVI	1998	F	Shkup	Shkup	Shkup	Shkup	Shkup	Shkup

Shkruani emrin e maturantit: 1 100

Filtro

A. Rasti kur emri i maturantit ndodhet në bazën e të dhënave të shkollës përkatëse.

Hapi i pestë - Mbikëqyrësi shkon tek rekordi përkatës i maturantit dhe klikon mbi linkun **Ndërsho**. Në faqen web që shfaqet më pas, jepen fushat përkatëse me të dhënat personale të maturantit, së bashku me të dhënat e tjera që maturanti ka plotësuar në Formularin A1, në Portalin e-albania, (siç tregohet në figurën më poshtë):

Ndërsho Maturantin

Shkollja *

Shkup - Shkup

Profil Shkolles *

04 - Gjeneral

Sexi *

☐ Po ☒ Jo

Data e lindjes *

☐ Po ☒ Jo

Shkollja që ka përfunduar *

☒ E njëjta ☐ E tjere

Viti i përfundimit të shkollës së mesme *

2023

Adresa *

Shkup

Karta Identifikuese *

142345678

ID e shtetit të maturantit *

14234

Emri *

Emri

Udhë *

Udhë

Hapi i gjashtë - Mbikëqyrësi, së bashku me maturantin, verifikon edhe një herë saktësinë në plotësimin e të dhënave përkatëse të maturantit, zgjedh nga listat përkatëse në fushat **Profili Shkolles** dhe **Lenda D3**, si dhe klikon mbi butonin **RUAJ**, për të ruajtur të dhënat e kësaj ndërfaqeje.

Në vëmendjen tuaj:

- Fusha e **profilit të shkollës** është tepër e rëndësishme, pasi mbi bazën e plotësimit të saj do të gjenerohen për secilin maturant testet e lëndëve të detyruara “Letërsi dhe Gjuhë Shqipe” dhe “Matematikë”.


Lënda D3 është gjuha e huaj e detyruar, të cilën maturanti e zgjedh për ta dhënë provim të detyruar në shkollë.

Gjithashtu edhe adresa e emailit duhet të jetë e saktë, pasi aty do të dërgohen kredencialet e maturantit, gjatë proceseve të mëtejshme të Maturës Shtetërore.

Hapi i shtatë - Pasi mbikëqyrësi klikon mbi butonin  shfaqet faqja web, në të cilën bëhet e mundur edhe njëherë verifikimi i lëndës me zgjedhje që maturanti ka zgjedhur nga plotësimi i Formularit A1 në Portalin e-albania, si dhe mundësia e ndryshimit edhe njëherë të lëndëve D3 dhe asaj me zgjedhje.

Plotësimi i pyetjes nëse maturanti do aplikojë për studime të larta jashtë vendit duhet plotësuar **me kujdes**, sidomos për rastet kur maturantët kanë planifikuar që të studiojnë jashtë vendit.

Pasi të dhënat e maturantit u ruajtën me sukses, shfaqet tabela si më poshtë për të zgjedhur tipin e formularit:



Zgjedhim optionin “Plotëso Formularin A1” dhe do shfaqet formulari si më poshtë:

Shto Formular A1

Maturant *

234003100006-Shpresa--Mehmeti

Aplikon jashtë vendit *

☐ Po ☒ Jo

Lëndë me Detyrim

D3: Anglisht (D3) X v

Lëndë me Zgjedhje

Z1: Kimi (Z1) X v

 Anullo

KSHMSH monitoron të gjithë procesin e plotësimit të formularëve AI/ALZ, të cilët shkarkohen nga sistemi dhe nënshkruhen nga drejtori i shkollës, mbikqyrësi i formularëve dhe mësuesi kujdestar përkatës. Listën e maturantëve që kanë plotësuar këta formularë (në dy kopje), ia përcjell zyrtarisht ZVAP-it .


Mbikëqyrësi ka për detyrë të verifikojë dhe sigurojë për secilin maturant që plotësimi i formularit A1 është bërë konform udhëzimeve përkatëse për këtë proces.

Mbikëqyrësi kushtet e udhëzimeve të mësipërme ia bën të njohur secilit maturant.

Nëse duhet rizgjedhur lënda me zgjedhje atëherë klikohet mbi butonin X për të fshirë lëndën që nuk duam ta zgjedhim dhe në menunë e listës rënëse zgjidhet një lëndë tjetër me zgjedhje, të cilën maturanti dëshiron ta japë provim.

Pasi maturanti dhe mbikëqyrësi kanë përfunduar përzgjedhjen e lëndëve D3 dhe atë me zgjedhje, klikohet mbi butonin .

Hapi i tetë: Pasi klikohet mbi butonin  shfaqet faqja me të dhënat e plota për Print të Formularit A1.



[Modifiko Formularin](#) [Shkarko Formularin](#)

Formular A1

Për regjistrimin e maturantëve në regjistrin e maturës shtetërore

Pletësimi i formularit u krye me sukses.

1. Dar ose Za	Elbasan
2. Qyteti/Fshati	Elbasan
3. Shkolla	Test 1
4. Profili	Gjimnaz
5. Emri	Johari
6. Atësia	a
7. Mbiemri	Bujari
8. NID	A12345628G
9. ID e maturantit	234103300049
10. ID e vjetër e maturës	
11. Datëlindja	12/04/2010
12. Vendlindja	Tirane
13. Gjinia	Mashkull
14. Telefoni	0692337745
15. Email	j.bujari@gmail.com
16. Aplikoni jasht shtetit?	Jo

Mesazhi: **Sukses** tregon se aplikimi për Formularin A1 ka përfunduar me sukses dhe se të dhënat e aplikimit të maturantit janë ruajtur në bazën e të dhënave. Në këtë dritare kemi disa mundësi:

- Klikohet mbi ikonën  shkarko formularin për të ruajtur aplikimin në format p.sh. pdf dhe për ta printuar më pas;
- Klikohet mbi linkun [Modifiko Formularin](#) për të riparë edhe njëherë të dhënat e lëndëve dhe për të bërë modifikime nëse kemi vendosur dicka gabim.

Hapi i nëntë: Për të verifikuar statuset e aplikimeve klikohet tek menuja  dhe shfaqet faqja siç tregohet në figurën më poshtë (*Konfirmuar nënkupton përfundimin e aplikimit*):

Konfirmimi i A1/A1Z

Matura ID ID	NID ID	Emri ID	Autoka ID	Maturant ID	Data lindja ID	Shkolla ID	Profil ID	ANP ID	Vjehtësi ID	Status ID
234103300049	A123456789	Johan	A	Bujan	12/04/2010	Test 1	Gjymnaz	Jo	Jo	Konfirmuar
234103300048	J541150501	Ejra	Artur	Harli	02/10/2012	Petro Neri Lubani	Gjymnaz	Jo	Jo	Në pritje
234103300047	1234567890	Fjori	Fjori	Fjori	10/10/2013	Test 1	Gjymnaz	Jo	Jo	Konfirmuar
234103300046	K123456789	Harly	Agim	Bujan	03/10/2011	Test 1	Profili shqiptar	Jo	Jo	Konfirmuar
234103300045	K123456789	Harly	Agim	Pichez	09/10/2013	Test 1	Profili shqiptar	Jo	Jo	Në pritje
234103300044	1234567890	Ariela	Ariela	Canjani	10/10/2013	Test 1	Gjymnaz	Jo	Jo	Konfirmuar

Tek kjo listë verifikohet se:

- cilët aplikime janë konfirmuar si të përfunduara, që do të thotë aplikimi ka përfunduar dhe është printuar formulari,
- dhe cilët janë të pakonfirmuar (*nuk kanë zgjedhur lëndën me zgjedhje, u mungon profili apo të dhëna të tjera dhe formulari i tyre nuk është printuar*). Konfirmimi i formularëve bëhet duhet ndjekur të gjithë hapat e treguar më sipër (1-9).

Duhet të verifikohet seksioni



dhe çdo aplikim i shkollës duhet të jetë në statusin konfirmuar. Në rast se ka aplikime në pritje, duhet të njoftohet QSHA për arsyen që aplikimi është në këtë status.

B. Rasti kur emri i maturantit nuk ndodhet në bazën e të dhënave të shkollës përkatëse.

Në rast se mbikëqyrësi e kërkon maturantin në sistem si në pikën 4 më sipër, por rezulton se ai nuk gjendet i regjistruar, atëherë maturanti udhëzohet që të plotësojë më parë aplikimin me A1 në portalin e-albania dhe më tej të vijojë me plotësimin e të dhënave të tjera dhe konfirmimin e formularit në portalin e maturës.

APLIKIMI ME FORMULARIN A1Z NGA PROFILI I MBIKQYRËSIT NË PORTALIN E MATURËS SHETËRORE

Hapi i parë: Mbikëqyrësi hap një nga browser-at Internet Explorer/Firefox/Chrome/etj.
Tek fusha e adresës web plotësohet <http://ematura.qsha.gov.al> dhe shtypet ENTER.
Hapet faqja kryesore e Portalit të Maturës Shtetërore.

Hapi i dytë: Aksesimi në sistem do të bëhet me kredencialet e e-Albania. Ata duhet të kenë të konfiguruar te përdoruesi i tyre në sistem NID-in/numrin personal. Për arsye të veçanta kur këta përdorues do duan të aksesojnë sistemin e maturës me përdorues dhe fjalëkalim (pra jo nga e-Albania) duhet të bëjnë një kërkesë tek QSHA dhe aty do t'u autorizohet identifikimi përmes përdoruesit dhe fjalëkalimit përkatës.

për të aksesuar sistemin. Pasi vendosim kredencialet e sakta klikojmë mbi butonin  siç tregohet në figurën më poshtë :



Hapi i tretë: Pasi mbikëqyrësi klikon mbi butonin , hapet faqja web me ambientin e punës së mbikëqyrësit, në të cilën majtas gjenden menutë kryesore të punës dhe po në të majtë në fund tregohet roli i përdoruesit, në këtë rast është mbikëqyrës formularësh.



Urdhër

Urdhër për miratimin e llojeve të testeve për Maturën Shtetërore dhe Maturën Shtetërore Profesionale



Urdhër për miratimin e formularëve A1 dhe A1Z për Maturën Shtetërore dhe Maturën Shtetërore Profesionale



Urdhër për miratimin e kalendarit për Maturën Shtetërore dhe Maturën Shtetërore Profesionale



Aplicimet:

Hapi i katërt: Klikohet mbi

Maturantë

dhe djathtas shfaqen fushat siç tregohet në figurën më poshtë:

Maturantë											
Adresa	Matura ID	KOD	Emri	Adresa	Mësimi	Datëlindja	Sikolla	Profil	Kyqen nga + Adresa	AN	Vjeneti
Adresa	II V	II V	II V	II V	II V	II V	II V	II V	II V	II V	II V
Kyqen nga + Adresa	23400200004	502450076	Urota	Enda	Qemali	11/11/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200001	A10605070	Susda	Nalm	Kuq	15/04/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200000	212315052	Flori	Flori	Flori	06/11/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200079	A10345070	Ajela	Edmir	Xhuf	14/05/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200077	K12345070	Robert	Vasil	Shari	18/12/2012	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200074	P12345070	Pranvera	Iir	Ajela	26/02/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200054	100075001	eris	Artur	babai	11/11/1995	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200052	K12402020	Ajela	Ajela	Ajela	02/10/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200041	123456700	Ajela	Ajela	Carteji	10/10/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo
Kyqen nga + Adresa	23400200040	K24150701	Ajela	Ajela	Ajela	10/10/2013	Bankë Sija	Gjenerat	Jo	Jo	Jo

Në këtë portal do të bëhet vazhdimi i aplikimit për kandidatët që kanë aplikuar më parë me Formularin A1Z nga faqja e Portalit e-albania.

Veprimi i parë që kryen mbikëqyrësi është verifikimi nëse emri i kandidatit ndodhet në bazën e të dhënave të shkollës së tij, duke plotësuar të dhënat e kandidatit në fushat e emrit apo mbiemrit dhe

duke klikuar mbi butonin **KERKO** dhe duke e verifikuar kandidatin nga lista e kandidatëve, siç tregohet në figurën më poshtë:

A. Rasti kur emri i kandidatit ndodhet në bazën e të dhënave të shkollës përkatëse.

Hapi i pestë: Mbikëqyrësi shkon tek rekordi përkatës i kandidatit dhe klikon mbi linkun **Ndrijo**. Në faqen web që shfaqet më pas, jepen fushat përkatëse me të dhënat personale të kandidatit, së bashku me të dhënat e tjera që kandidati ka plotësuar në Formularin A1Z, në Portalin e-albania. (siç tregohet në figurën më poshtë):

Hapi i gjashtë: Mbikëqyrësi, së bashku me kandidatin, verifikon edhe një herë saktësinë në plotësimin e të dhënave përkatëse të kandidatit, zgjedh nga listat përkatëse në fushat

Profili Shkolles dhe Lenda [3], si dhe klikon mbi butonin **RUAJ**, për të ruajtur të dhënat e kësaj ndërfaqje.

Në vëmendjen tuaj:

Fusha e **profilit të shkollës** është tepër e rëndësishme, pasi mbi bazën e plotësimit të saj do të gjenerohen për secilin kandidat testet e lëndëve të detyruara “Letërsi dhe Gjuhë Shqipe” dhe “Matematikë”. Lënda D3 është gjuha e huaj e detyruar, të cilën kandidati e zgjedh për ta dhënë provim të detyruar në shkollë ose për ta mbartur.

Fusha e **Old ID** duhet plotësuar patjetër. Në bazë të kësaj fushe lidhen të dhënat e kandidatit ndër vite.

Hapi i shtatë: Pasi mbikëqyrësi klikon mbi butonin  shfaqet faqja në të cilën bëhet e mundur plotësimi i të dhënave për lëndët e detyrueshme dhe ato me zgjedhje.

Siç tregohet në figurën më poshtë : Në këtë faqe jepet mundësia e plotësimit të kuadratisht **“Keni marrë diplomë/dëftesë pjekurie”**, në rast se e keni marrë diplomën më parë duhet klikoni **PO** pasi ky është një nga parametrat ku mbështetet sistemi për prodhimin e diplomave.
(Kujtojmë se maturanti mund të pajiset vetëm një herë me diplomë)

Hapi i tetë : Rubrika - Lëndët e detyruara

8.1. Lëndët e detyruara që do të mbarten

Në këtë rubrikë duhet të deklarohen lëndët e detyruara që do të mbarten. (kujtojmë mund të mbartet vetëm rezultati i një lënde që është ≥ 4.50).

- Në momentin që kandidati mbart një notë tek kutia nota e mbartur vendosim manualisht notën.
- Nuk plotësojmë asnjë fushë në rastet kur kandidati ka notë kaluese të MSH, në njërën nga lëndët D1,D2,D3 . Në këtë rast sistemi e ka gjetur rezultatin dhe e ka shfaqur atë në zonën “Nota e Gjetur “. Nëse ju gjatë ballafaqimit me vërtetimin e notave që lëshon ZVAP për secilin kandidat për t’u regjistruar në MSH, ju rezulton se kandidati ka një notë tjetër për këtë lëndë atëherë në kolonën Nota D1 ose Nota D2 ose Nota D3 , sipas rastit, do të shkruani notën e lëndës që ju konfirmoni se kandidati ka. Njëkohësisht në kutinë ARSYE, duhet të jepni patjetër arsyen pse po vendosni këtë notë, e cila është e ndryshme nga ajo që gjendet në sistem. **(Notat duhet të shkruhen të shkallëzuara, jo nota të rrumbullakosura).**

Në vëmendjen tuaj:

Mund të ndodhë që sistemi nuk e ka gjetur notën e lëndës që do të mbartet edhe pse kandidati e ka dhënë provim atë lëndë në vitet e mëparshme dhe ka notë kaluese. Atëherë në këto raste, ju do të shkruani notën e shkallëzuar që mbartet, bazuar në vërtetimin që ka lëshuar ZVAP si dhe në certifikatën e notave të lëshuar nga shkolla dhe njëkohësisht në kolonën arsye do shkruani sqarimin. (psh. këtë notë e ka marrë në MSH të vitit ...).

Shto Formularin A1Z

Maturant *	234003700048-Eora-Habifi
Aplikon jashtë vendit? *	☐ Po ☒ Jo
Keni marrë diplomë/dëftesë pjekurie? *	☐ Po ☒ Jo
Viti i përfundimit të shkollës së mesme	2023

Lëndët e Detyruara

Lënda	Nota e Gjetur	Nota	Anxetimi
D1: Gjuhë Shqipe dhe Letërsi		5.50	
D2: Matematikë		5.38	
D3: Anglisht (D3)	X	6	

8.2. Lëndët e detyruara që do të jepen provim

Të dhënat në lidhje me lëndët e detyruara që do të jepen provim, plotësohen nga vetë sistemi në varësi të **profilit të shkollës** si dhe në varësi të të dhënave që ju keni futur apo keni verifikuar më sipër në pikën 8.1, lëndët e detyruara që do të mbarten.

Vetëm për lëndën D3 duhet të bëni kujdes dhe të zgjidhni nga lista, lëndën që duhet të japë provim kandidati, e cila mund të jetë “Nuk kam detyrim”. Mbikëqyrësi bashkë me kandidatin zgjedh opsionin “Nuk kam detyrim” për lëndën D3, në rastet kur ai ka qenë maturant para MSH 2014, dhe si pasojë nuk e ka detyrim ta japë këtë lëndë.

Hapi i nëntë: Rubrika - Lëndët me zgjedhje

9.1. Lënda me zgjedhje që do të mbartet

Në këtë rubrikë jepet mundësia:

- Të mos mbartet asnjë lëndë, duke zgjedhur “JO”.** Këtë opsion e përdorim kur:
 - kandidati nuk ka dhënë lëndë me zgjedhje dhe si pasojë nuk ka lëndë për të mbartur. Në këtë rast ai duhet të zgjedhë më poshtë për të dhënë provim një lëndë me zgjedhje nga lista e lëndëve me zgjedhje të MSH 2026.
 - kandidati është ish maturant i shkollave profesionale dhe ka mbetur në provimin e MSH për lëndën e teorisë profesionale, por ka kaluar në lëndën tjetër me zgjedhje, atëherë ai zgjedh “Jo” në këtë rubrikë dhe më poshtë është i detyruar të zgjedhë për të dhënë provim lëndën e teorisë profesionale sipas profilit të shkollës së tij.

Lëndët me Zgjedhje

Mbart Notë Lënda

Z1 Jo

Anullo

b) të mbartet 1 lëndë me zgjedhje kur:

- kandidati është pajisur me diplomë dhe ka dhënë 1 lëndë me zgjedhje në MSH.
- kandidati është pajisur me diplomë dhe ka dhënë 2 lëndë me zgjedhje në vitet e mëparshme. Nga këto dy lëndë që ka dhënë, zgjedh një të një prej tyre, që mund të jetë ajo me notë më të lartë, ose lënda që i jep më shumë përparësi në degën e IAL që do të zgjedhë më tej.
- kandidati është pajisur me diplomë dhe ka dhënë 3 lëndë në MSH 2012. Nga këto tri lëndë që ka dhënë, zgjedh një të një prej tyre, që mund të jetë ajo me notë më të lartë, ose lënda që i jep më shumë përparësi në degën e IAL që do të zgjedhë më tej.
- kandidati nuk është pajisur me diplomë sepse ka dhënë dy provime me zgjedhje por ka mbetur në një të një prej tyre, apo ka dhënë tri provime me zgjedhje por ka mbetur në një të një prej tyre ose në dy prej tyre. Në këto raste ai zgjedh të mbartet lëndën në të cilën ka notë kaluese dhe pret që të pajiset me diplomë në përfundim të procedurave të MSH 2026.
- Kandidati është ish maturant i shkollave profesionale dhe ka dhënë dy apo tri provime me zgjedhje ku ndër këto lëndë njëra është teori profesionale, atëherë ai mbart notën e teorisë profesionale, kur ajo është notë kaluese dhe pret të pajiset me diplomë edhe pse mund të ketë nota jo kaluese në lëndët e tjera me zgjedhje që ka dhënë në vitet më parë.

Për të gjitha rastet e përmendura në këtë pikë, për të mbartur lëndën me zgjedhje duhet të zgjidhet viti kur e ka dhënë këtë lëndë, të zgjidhet lënda me zgjedhje që ai ka dhënë (këtu do të gjeni listën e plotë të lëndëve me zgjedhje ndër vite).

Edhe këtu sistemi do të shfaqë notën e lëndës me zgjedhje nëse ai e ka gjetur, në rast të kundërt mbikëqyrësi e shkruan notën e shkallëzuar të kësaj lënde si dhe arsyen në kolonën përkatëse. Gjithashtu mbikëqyrësi e shkruan notën e shkallëzuar të kësaj lënde si dhe arsyen në kolonën përkatëse edhe kur nota e gjetur nga sistemi nuk përkon me atë që ZVAP ka vërtetuar në dokumentin e regjistrimit për kandidatin në fjalë.

Lëndët me Zgjedhje

Mbart Notë	Viti	Lënda	Nota e Gjetur	Nota	Arsyetimi
Z1	Po v	2023 v	Biologji Profesionale (Z1) X v	6	

Anullo

Mbikqyrësi ka për detyrë të verifikojë për secilin kandidat, saktësinë e rezultateve të lëndëve të mbartura, dhe zgjedhjen që ka bërë kandidati të lëndës me zgjedhje nëse ato i plotësojnë kushtet e udhëzimeve përkatëse për plotësimin e A1Z. Mbikqyrësi, kushtet e këtyre udhëzimeve ia bën të njohur secilit kandidat.

KSHMSH monitoron të gjithë procesin e plotësimit të formularëve AI/ALZ, të cilët shkarkohen nga sistemi dhe nënshkruhen nga drejtori i shkollës, mbikqyrësi i formularëve dhe mësuesi kujdestar përkatës. Listën e maturantëve që kanë plotësuar këta formularë (në dy kopje), ia përcjell zyrtarisht ZVAP-it .

Pasi shqyrtohen rastet dhe ndiqen hapat si më sipër për çdo situatë, në

fund klikohet mbi butonin .

Në vëmendjen tuaj:

Fusha e **profilit të shkollës** është tepër e rëndësishme, pasi mbi bazën e plotësimit të saj do të gjenerohen për secilin kandidat testet e lëndëve të detyruara "Letërsi dhe Gjuhë Shqipe" dhe "Matematikë". Lënda D3 është gjuhë e huaj e detyruar, të cilën kandidati e zgjedh për ta dhënë provim të detyruar në shkollë. Gjithashtu edhe adresa e emailit duhet të jetë e saktë, pasi aty do të dërgohen kredencialet e kandidatit, gjatë proceseve të mëtejshme të Maturës Shtetërore. Fusha e **Old ID** duhet plotësuar patjetër. Në bazë të kësaj fushe lidhen të dhënat e kandidatit ndër vite.

Hapi i dhjetë: Pasi klikohet mbi butonin  shfaqet faqja me të dhënat e plota për Print të Formularit A1Z.

Mesazhi **SUKSES** tregon se aplikimi për Formularin A1Z ka përfunduar me sukses dhe se të dhënat e aplikimit të kandidatit janë ruajtur në bazën e të dhënave.

Sukses

Formulari A1Z u shtua me sukses!



Modifiko Formularin

Shkarko Formularin

Formular A1Z

Për regjistrimin e maturanëve në regjistrin e maturës shtetërore

Plotësimi i formularit u krye me sukses.

1. Dar ose Za	Elbasan
2. Qyteti/Fshati	Elbasan
3. Shkolla	Test 1
4. Profili	Gjimnaz
5. Emri	Artemis
6. Atësia	Bashkim
7. Mbiemri	Muca
8. NID	A12345678P
9. ID e maturanit	234103300050
10. ID e vjetër e maturës	1234567
11. Datëlindja	05/07/2010
12. Vendlindja	Tirane
13. Gjinia	Mashkull
14. Telefoni	0692336541
15. Email	artemis.muca@gmail.com
16. Aplikoni jasht shtetit?	Jo

Në këtë dritare kemi disa mundësi:

- Klikohet mbi ikonën shkarko formularin për të ruajtur aplikimin në format p.sh. pdf dhe për ta printuar më pas;

Modifiko Formularin

- Klikohet mbi linkun për të riparë edhe njëherë të dhënat e lëndëve dhe për të bërë modifikime nëse është e nevojshme.

Për të verifikuar statuset e aplikimeve klikohet tek menuja  dhe shfaqet faqja siç tregohet në figurën më poshtë (*Konfirmuar nënkupton përfundimin e aplikimit*):

Konfirmimi i A1/A1Z

Matura ID TI V	NID TI V	Emri TI V	Ajësia TI V	Mbiemri TI V	Data lindja TI V	Shkollë TI V	Profili TI V	A1Z TI V	Vjehtë TI V	Statusi TI V
234103300050	A12345678P	Artan	Sushkim	Muca	05/07/2010	Test 1	Gjimnaz	Jo	Jo	Konfirmuar
234103300049	A12345678G	Jolun	a	Dujun	12/04/2010	Test 1	Gjimnaz	Jo	Jo	Konfirmuar
23400370004E	156119060L	Bora	Artur	Mabik	02/10/2013	Petro Nuci Luarsaj	Gjimnaz	Jo	Jo	Në pritje
234103300047	123456789D	Fjori	Fjori	Fjori	10/10/2013	Test 1	Gjimnaz	Jo	Jo	Konfirmuar
234103300046	K12343478P	Halil	Ajton	Bujari	09/10/2013	Test 1	Profili shoqëror	Jo	Jo	Konfirmuar
234103300045	K12545578P	Halil	Ajton	Fischer	09/10/2013	Test 1	Profili shoqëror	Jo	Jo	Në pritje
234103300044	123456789D	Ajela	Ajela	Canari	10/10/2013	Test 1	Gjimnaz	Jo	Jo	Konfirmuar
234003200043	K12431222K	Ajela	Ajela	Ajela	09/10/2013	Scenari Sykja	Gjimnaz	Jo	Jo	Konfirmuar

Tek kjo listë verifikohet se:

- cilët aplikime janë konfirmuar si të përfunduara, që do të thotë aplikimi ka përfunduar dhe është printuar formulari,
- dhe cilët janë të pakonfirmuar (*nuk kanë zgjedhur lëndën me zgjedhje, u mungon profili apo të dhëna të tjera dhe formulari i tyre nuk është printuar*). Konfirmimi i formularëve behet duhet ndjekur të gjithë hapat e treguar më sipër.(1-9).

Duhet të verifikohet seksioni



dhe çdo aplikim i shkollës duhet të jetë në statusin konfirmuar. Në rast se ka aplikime në pritje, duhet të njoftohet QSHA për arsyen që aplikimi është në këtë status.

B. Rasti kur emri i kandidatit nuk ndodhet në bazën e të dhënave të shkollës përkatëse.

Në rast se mbikëqyrësi e kërkon kandidatin në sistem si në pikën 4 më sipër, por rezulton se ai nuk gjendet i regjistruar, atëherë kandidati udhëzohet që të plotësojë më parë aplikimin me A1Z në portalin e-albania dhe më tej të vijojë me plotësimin e të dhënave të tjera dhe konfirmimin e formularit në portalin e maturës.

Aplikimi me Formularin A1 (Maturantë 2025-2026)	
Datë	Aplikuesit sipas DRAP-eve
02.02.2026	DRAP Tiranë, Durrës, Fier
03.02.2026	DRAP Tiranë, Durrës, Fier
04.02.2026	DRAP Tiranë, Durrës, Fier
05.02.2026	DRAP Korçë, Lezhë
06.02.2026	DRAP Korçë, Lezhë
09.02.2026	DRAP Korçë, Lezhë

Aplikimi me Formularin A1 dhe Formularin A1Z	
Datë	
10.02.2026	DRAP Tiranë, Durrës, Fier, Korçë, Lezhë
11.02.2026	DRAP Tiranë, Durrës, Fier, Korçë, Lezhë